


**KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS**  
**KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE**
**Nr. 01/2021**
**Datë: 21.01.2021**

Në mbështetje të Nenit 6, Pika 4 nën k e Statutit të Komitetit Olimpik të Kosovës, si dhe bazuar në ekstraktin e mbledhjes së BE së KOK-ut me nr. (56) pesëdhjetë e pestë të mbajtur më 19.01.2021, Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik të Kosovës mori:

**V E N D I M**

*mbi ndryshimin e tërësishëm të vendimeve me nr. 33-2020 dhe 39-2020*

1. Rritet mbështetja financiare për Bursistët Olimpikë të KOK të cilët po e ndjekin Normën Olimpikë Tokyo 2020.
2. Mbështetja financiare e Bursistëve Olimpikë nga KOK, bëhet si më poshtë:
  - a) Caktohet mbështetja financiare për përgatitje në kampe stërvitore ndërkombëtare të verifikuara nga Federatat përkatëse Evropiane ose Botërore, në vlerë deri në 100 Euro në ditë për një sportistë, bazuar në kategorinë përkatëse sipas pikës 3 të këtij Vendimi;
  - b) Caktohet mbështetja financiare për përgatitje në kampe stërvitore vendore dhe të rajonit (Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Mal i Zi, Bullgari) për periudhën sa zgjatë pandemia Covid-19, në vlerë deri në 60 Euro në ditë për një sportistë; bazuar në kategorinë përkatëse sipas pikës 3 të këtij Vendimi;
  - c) Mbështetje financiare për një garë të rëndësishme kualifikuese për ndjekjen e Normës Olimpikë Tokyo 2020 për secilin sportistë;
3. Bursistët e KOK të cilët do të mbështeten financiarisht për përgatitje në kampe stërvitore ndërkombëtare dhe kampe vendore e rajonale, janë ndarë në tri kategori: kategoria Sportistët Evident, kategoria Sportistët Potencial dhe kategoria Sportistët Shpresë:
  - i. **Grupit të parë (evident)** i takojnë sportistët që rangohen në pozitën deri në numrin 30 të Ranglistës Olimpikë e që përbëhet nga: Majlinda Kelmendi (xhudo), Egzon Shala (mundje), Nora Gjakova (xhudo), Distria Krasniqi (xhudo), Akil Gjakova (xhudo) dhe Lorian Kuka (xhudo), ku KOK do t'ua mbulojë shpenzimet deri në 80 ditë përgatitje;
  - ii. **Grupit të dytë (potencial)**, i takojnë sportistët që rangohen në pozitën nga numri 31 e deri në numrin 60 të Ranglistës Olimpikë e që përbëhet nga: Elhami Shabani (karate), Laura Fazliu (xhudo) dhe Donjeta Sadiku (boks), ku KOK do t'ua mbulojë shpenzimet deri në 40 ditë përgatitje;  
*Sqarim: Dihet se AIBA nuk ka ranglistë olimpikë, andaj BE i KOK bazuar në sukseset e Donjetës, vendosi që ajo t'i përkas kësaj kategorie.*
  - iii. **Grupit të tretë (shpresë)**, i takojnë sportistët që rangohen në pozitën mbi numrin 61 të Ranglistës Olimpikë e që përbëhet nga: Herolind Nishevci (karate), Fortesa Orana (karate) Musa Hajdari (atletikë), Astrit Kryeziu (atletikë), Urata Rama (shenjëtari), Dasar Xhambazi (not), Fjorda Shabani (not), Atdhe Luzhnica (shigjetari), Edon Shala (mundje), Drilon Ibrahim

KOSOVO



**KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS**  
**KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE**

(shenjëtari) dhe Arti Krasniqi (not), ku KOK do t'ua mbulojë shpenzimet deri në 20 ditë përgatitje.

4. Mbështetja sipas pikës 3, a dhe b e këtij Vendimi do të vlejë në bazë të Ranglistës Olimpikë, të cilën e ka hulumtuar vet KOK dhe të cilën e ka dëshmuar Federata përkatëse. Në rast se ndonjë sportistë ndërron pozitën në Ranglistën Olimpikë, automatikisht do të vlejë mbështetja sipas rangimit të ri.
5. Mjetet mund të shpenzohen për: bileta, hotel, ushqim, pije jo alkoholike, kamp stërvitor dhe për trajnerë, mirëpo nuk lejohet që mjetet që ndahen nga KOK, të shpenzohen për persona tjerë.
6. Mjetet për shpenzime i alokon KOK tek federata përkatëse ose direkt tek operatori, nëse një gjë e tillë është e mundur.
7. Në rast se KOK e vlerëson, 50% e shumës për secilin sportistë do të alokohet në formë avansi, pas aprovimit të kampit stërvitor nga KOK.
8. Pas përfundimit të përgatitjeve të sportistëve dhe arsytimit të shpenzimeve nga Federatat, ashtu si kërkohen me këtë vendim, do të alokohet edhe pjesa e mbetur e mjeteve prej 50%, apo shuma totale e shpenzimeve, nëse KOK paraprakishtë nuk e ka miratuar alokimin e shumës së avansit prej 50%.
9. Nuk do të kompensohen federatat për shpenzime në kampet e lartpërmendura pa aprovimin e KOK.
10. Mjetet arsyetohen vetëm me fatura të rregullta dhe vetëm për pozicionet e cekura më lartë.
11. Obligohet Departamenti i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
12. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Sekretari i Përgjithshëm i KOK dhe vlen deri më 30 qershor 2021, kur edhe do të mbyllet garat që vlerësohen me pikë për Normë Olimpikë.

**Vendimi i dërgohet:**

- Sekretari i Përgjithshëm
- Departamentit Financiar
- Palëve
- Zyrës Ligjore
- Arkivës

  
**K O S O V O**  
**KOMITETI OLIMPIK**  
**OLYMPIC COMMITTEE**  
*Shasiyar Haxhijaj*  
*Sekretar i Përgjithshëm i Komitetit Olimpik të Kosovës*